

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika AnchorFix®-1

ADEZIV ANKORIMI ME THARJE TË SHPEJTË



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Adeziv ankorimi me dy përbërës, pa tretës dhe stiren dhe me bazë poliesteri.

PËRDORIMET

Si një adeziv ankorimi me tharje të shpejtë për:

- Shufra / çelik për armaturë
- Shufra të filetuara
- Bulona dhe sisteme të posaçme mbërthimi
- Beton
- Mure zgavër dhe solide
- Gur natyror i fortë*
- Gur solid*

* Këto nënshtresa mund të variojnë së tepërmi, sidomos për sa i përket rezistencës, përbërjes dhe porozitetit. Si pasojë, në çdo aplikim duhet testuar përshtashmëria e adezivit Sika AnchorFix®-1 duke aplikuar fillimisht adezivin Sika AnchorFix®-1 në një zonë për provë. Kontrolloni veçanërisht për fuqinë e ngjites, njollosjen e sipërfaqes dhe çngjyrosjen.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Tharje e shpejtë
- Mund të përdoret pistoletë standarde
- Mund të përdoret në temperatura të ulëta
- Kapacitet i lartë për bartje ngarkese
- Disponohet miratimi ETA
- Nuk rrjedh, edhe në aplikime tavanore
- Pa stiren
- Arome e lehtë
- Sasi e pakët firoje

MIRATIME / STANDARDE

- Sistem injektimi për përdorim në muratura në përputhje me ETAG 029, ETA-12/0227, Deklarata e Performancës 020403010010000001 5034408, certifikuar nga organi i njoftuar për certifikimin e produkteve 0679, certifikatë e qëndrueshmërisë së performancës 0679-DPD-0777 dhe mbart markën CE.
- Ankorazh i ngjitur me metodën e injektimit për beton të pa plasaritur në përputhje me ETAG 001 anekset 1 dhe 5, ETA-13/0720, Deklarata e Performancës 020403010010000001 5034408, certifikuar nga organi i njoftuar për certifikimin e produkteve 1020, certifikatë e qëndrueshmërisë së performancës 1020-CPD-090-029816 dhe mbart markën CE.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Ambalazhi	tubetë standarde 300 ml	12 tubeta/ kuti paleta: 75 kuti
Ngjyra	Përbërësi A:	i bardhë
	Përbërësi B:	i zi
	Përbërësit A+B të përzierë:	gri e lehtë
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit Të gjitha tubetat e Sika AnchorFix®-1 kanë të shkruar datën e skadencës në etiketë.	

Kushtet e magazinimit Të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar në kushte të thata dhe temperatura midis +5 °C dhe +25 °C. Të mbrohet nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor.

Dendësia ~1.63 kg/l (përbërësit A+B të përzierë)

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj ngjeshjes ~60 N/mm² (7 ditë, +20 °C) (ASTM D 695)

Moduli i elasticitetit në ngjeshje ~3 500 N/mm² (7 ditë, +20 °C) (ASTM D 695)

Rezistenca ndaj tërheqjes në përkulje ~28 N/mm² (7 ditë, +20 °C) (ASTM D 790)

Rezistenca ndaj tërheqjes ~12 N/mm² (7 ditë, +20 °C) (ASTM D 638)

Moduli i elasticitetit në tërheqje ~4 500 N/mm² (7 ditë, +20 °C) (ASTM D 638)

Rezistenca termike

Afatgjatë	+50 °C
Afatshkurtër (1–2 orë)	+80 °C

Temperatura e tranzicionit të qelqit +60 °C (DIN EN ISO 6721-1)

Parametrat e projektimit Për detaje rreth dizenjimit të ankorimit me adezivin referohuni tek dokumentacioni që ofrohet: "Dokumentacion teknik Sika AnchorFix®-1"
Ref: 870 43 01

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzierjes Përbërësi A : Përbërësi B = 10 : 1 për vëllim

Trashësia e shtresës 3 mm max.

Rrjedha e varjes Nuk varet, edhe në aplikime tavanore

Temperatura e produktit Sika AnchorFix®-1 duhet të jetë në temperaturë midis +5 °C dhe +40 °C për aplikim.

Temperatura e mjedisit -10 °C min. / +40 °C max.

Pika e vesës Kujdes nga kondensimi.
Temperatura e nënshtresës gjatë aplikimit duhet të jetë të paktën 3 °C mbi pikën e vesës.

Temperatura e nënshtresës -10 °C min. / +40 °C max.

Koha e maturimit	Temperatura	Koha e veprimit - T _{gel}	Koha e tharjes - T _{cur}
	+30 °C	4 minuta	35 minuta
	+25 °C – +30 °C	4 minuta	40 minuta
	+20 °C – +25 °C	5 minuta	50 minuta
	+10 °C – +20 °C	6 minuta	85 minuta
	+5 °C – +10 °C	10 minuta	145 minuta
	+5 °C	18 minuta	145 minuta
	-10 °C ^{1 2}	30 minuta	24 orë

1 Temperatura minimale e tubetës: +5 °C

2 Aplikimi nuk mbulohet nga qëllimi i ETA ose nga çdo lloj miratimi tjetër.

UDHËZIME APLIKIMI


CILËSIA E NËNSHTRESËS

- Llaçi dhe betoni duhet të kenë rezistencën e kërkuar. Nuk është nevojë të jenë të moshës 28 ditësh.
- Duhet të verifikohet rezistenca e nënshtresës (beton, mur, gur natyror).
- Duhet të kryhen teste tërheqjeje (pull-out) nëse nuk dihet rezistenca e nënshtresës.


- Bira e ankorimit duhet të jetë gjithnjë e pastër, e thatë, pa vaj dhe graso, etj.
- Grimcat e lira duhet të hiqen nga birat.
- Shufrat e filetuara duhet të pastrohen plotësisht nga vaji, grasoja apo nga çdo lloj substancë dhe grimca si pislëku etj.

PËRZIERJA


Përgatitja e tubetës: 300 ml




1. Zhvidhosni dhe hiqni kapakun



2. Pritni shiritin mbrojtës



3. Vidhosni përzierësin statik




4. Vendosni tubetën në pistoletë dhe filloni aplikimin


Kur puna ndërpritet, përzierësi statik mund të lihet tek tubeta, vetëm pasi të jetë liruar presioni i pistoletës. Nëse kur filloni sërish punimet, rrëshira tek përzierësi statik është forcuar, atëherë duhet të vendoset një përzierës i ri.

METODA E APLIKIMIT / MJETET


Ankorime në mure solide / beton




Hapni birën me një trapan elektrik në diametrin dhe thellësinë e kërkuar. Diametri i birës së hapur duhet të përputhet me përmasat e ankorimit.




Bira e hapur duhet të pastrohet me një pompë fryrjeje ose me kompresor ajri, duke filluar nga fundi i birës. (të paktën 2x)
Kujdes: përdorni kompresorë pa vaj!




Bira e hapur duhet të pastrohet tërësisht me një furçë hekuri të posaçme (pastroni të paktën 2x). Diametri i furçës duhet të jetë më i madh se diametri i birës së hapur.




Bira e hapur duhet të pastrohet me një pompë fryrjeje ose me kompresor ajri, duke filluar nga fundi i birës. (të paktën 2x)
Kujdes: përdorni kompresorë pa vaj!




Bira e hapur duhet të pastrohet tërësisht me një furçë hekuri të posaçme (pastroni të paktën 2x). Diametri i furçës duhet të jetë më i madh se diametri i birës së hapur.




Bira e hapur duhet të pastrohet me një pompë fryrjeje ose me kompresor ajri, duke filluar nga fundi i birës. (të paktën 2x)
Kujdes: përdorni kompresorë pa vaj!




Pomponi rreth dy herë derisa të dy përbërësit të dalin në mënyrë uniforme. Mos e përdorni këtë material që sapo doli. Lironi presionin e pistoletës dhe pastroni majën e tubetës me një copë.



Injektoni adezivin brenda birës, duke filluar nga fundi, ndërsa tërhiqni ngadalë prapa përzierësin statik. Në çdo rast shmangni hyrjen e ajrit. Për bira të thella mund të përdoret tub zgjatimi.




Futni ankorimin me lëvizje rrotulluese brenda birës së mbushur. Një sasi e vogël adezivi duhet të dalë jashtë birës.
Kujdes: ankorimi duhet të vendoset brenda kohës së punueshmërisë.




Ndërkohë që rrëshira forçohet ankorimi nuk duhet të lëvizet apo t'i vendoset ngarkesë përsipër. Mirëmbajtja e pajisjeve bëhet duke përdorur Sika® Colma. Shpëlani mirë duart dhe lëkurën me ujë të ngrohtë dhe sapun.

Ankorime në mure me tulla




Hapni birën me një trapan në diametrin dhe thellësinë e kërkuar. Diametri i birës së hapur duhet të përputhet me përmasat e ankorimit dhe përmasat e grykëzës në formë site.


Shënim: tek nënshtresat që nuk janë solide, mos përdorni trapan rrotullues me goditje.




Bira e shpuar duhet të pastrohet tërësisht me një furçë të rrumbullakët (fshini të paktën 1x). Diametri i furçës duhet të jetë më i madh se diametri i birës së hapur.




Bira e hapur duhet të pastrohet pas çdo hapi një pompë fryrjeje ose me kompresor ajri, duke filluar nga fundi i birës. (pomponi të paktën 1x)
Kujdes: përdorni kompresorë pa vaj!




Vendosni brenda birës së shpuar të gjithë grykëzen në formë site.




Pomponi rreth dy herë derisa të dy përbërësit të dalin në mënyrë uniforme. Mos e përdorni këtë material që sapo doli. Lironi presionin e pistoletës dhe pastroni majën e tubetës me një copë.




Injektoni adezivin në birë, duke filluar nga fundi, ndërsa tërhiqni ngadalë prapa përzierësin statik. Në çdo rast shmangni bllokimin e ajrit.



Mbyllni kapakun e grykëzës në formë site për të shmangur rrjedhjen e rrëshirës gjatë vendosjes së shufrës së çelikut.



Vendosni ankorimin me lëvizje rrotulluese brenda në grykëzën e mbushur. Përdorni madhësinë e përshtatshme të shufrës së çelikut. Kujdes: ankorimi duhet të vendoset brenda kohës së punueshmërisë.



Ndërkohë që rrëshira forcohet ankorimi nuk duhet të lëvizet apo t'i vendoset ngarkesë përsipër. Lani veglat menjëherë me Sika® Colma Cleaner. Shpëlani duart dhe lëkurën me ujë të ngrohtë dhe sapun.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me Sika® Colma Cleaner menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar/ i tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

DOKUMENTA SHITESË

Për detaje dizenjimi, ju lutemi referohuni në dokumentacionin e ofruar: Dokumentacion teknik Sika AnchorFix®-1 Ref: 870 43 01

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sika AnchorFix®-1

Mars 2019, Botimi 02.01

020205010010000001

SikaAnchorFix-1-sq-AL-(03-2019)-2-1.pdf